



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-8402 të datës 21.02.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 28.02.2025, , pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR INICIATIVËN PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS - IADK

- I. MIRATOHET**, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **7.285.20 €** (shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë euro e njëzet cent), Iniciativës për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës-IADK, konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-8402 të datës 21.02.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK
- II.** Ndarja e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-320/01-8402 të datës 21.02.2025 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK , sipas kostos së bashkëfinancimit të përcaktuar për vitin 2025 për Komunën e Lipjanit me qëllim të implementimit të projektit të përbashkët me titull **“Fuqizimi i grave , burrave dhe të rinjëve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit”**, financuar nga FRIEDA dhe zbatuar nga IADK.
- III.** Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për vitin 2025 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-9575

Lipjan, më 28.02. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

